

URDHËR
Nr. 436, datë 6.7.2018

**PËR MOSLICENCIMIN E SHOQATËS ELITE SI AGJENCI E ADMINISTRIMIT
KOLEKTIV NË FUSHËN E TË DREJTAVE TË ARTISTËVE INTERPRETUES DHE
EKZEKUTUES**

Në mbështetje të pikës 4, nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; të udhëzimit nr. 5166, datë 20.10.2016, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shitesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj”, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; si dhe kërkesës së shoqatës ELITE për pajisjen me licencë me nr. 3009 prot., datë 2.5.2018; të urdhrit të ministrit të Kulturës nr. 205, datë 4.4.2018, “Për ngritjen e grupit të punës, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për licencim/ripërtëritjen e tyre në fushat e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ndryshuar me urdhrin nr. 228, datë 17.4.2018 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 205, datë 4.4.2018”, si dhe legjislacionin në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse”,

KONSTATOVA:

a) Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga kuadri ligjor për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me to, në fushën e administrimit kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues, si dhe nga shqyrtimi i të gjithë dokumentacionit të depozituar nga shoqata ELITE, memos dhe relacionit të hartuar nga grupi i punës, rezulton se kjo shoqatë nuk i plotëson kriteret që ligji përcakton për t’u pajisur me licencë, si agjenci e administrimit kolektiv.

URDHËROJ:

1. Moslicencimin e shoqatës ELITE si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues.

2. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

3. Kundër këtij urdhri, kërkesi ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro Furxhi